



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.21**

**12 mars**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 11 mars 2010	Për liberalizimin e vizave me Bashkimin Europian .....	649
Vendim i Kuvendit nr.21, datë 4.3.2010	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar .....	650
Vendim i Kuvendit nr.22, datë 4.3.2010	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit” .....	650
Dekret nr.6436 datë 24.2.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	653
Dekret nr.6442 datë 3.3.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare .....	654
Dekret nr.6443 datë 3.3.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare .....	655

## REZOLUTË

### PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE ME BASHKIMIN EUROPIAN

Në përmbushje të misionit të Kuvendit, si përfaqësues të zgjedhur, të qytetarëve shqiptarë;  
Në respekt të plotë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe synimit madhor të shqiptarëve për të qenë pjesë me të drejta të plota në familjen europiane;

Të vendosur për të zbatuar detyrimet që rrjedhin gjatë procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European;

#### **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur sot, në datën 11.3.2010,**

- *Me bindjen* se lëvizja e lirë e njerëzve çon në forcimin e lidhjeve njerëzore, ekonomike, kulturore dhe shkencore midis Shqipërisë dhe Bashkimit European, duke u bërë kështu mbështetje për një Shqipëri që përparon nëpërmjet forcimit të demokracisë, ekonomisë së tregut dhe vlerave të shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve;

- *Duke çmuar* dialogun me BE-në për liberalizimin e vizave, si mbështetje për plotësimin e detyrimeve dhe si një proces të bazuar në përmbushjen e kushteve të vendosura në Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave;

- *Duke vlerësuar* angazhimin e Parlamentit dhe Këshillit të BE-së për liberalizimin e vizave me Shqipërinë sa më shpejt që të jetë e mundur, të shprehur në deklaratën e përbashkët të Këshillit dhe Parlamentit më 12 nëntor 2009;

- *I bindur* se liberalizimi i regjimit të vizave është pjesë e procesit të integritit european të Shqipërisë;

- *Duke konsideruar* se ky proces është në dobi të zhvillimit dhe stabilitetit të rajonit të Ballkanit Perëndimor;

#### **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:**

- Konfirmon mbështetjen e të gjitha forcave politike të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për liberalizimin e shpejtë të vizave dhe mbështet me vendosmëri lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë në hapësirën *Schengen*;

- Çmon arritjet e institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve të procesit të liberalizimit të vizave dhe mbështet përpjekjet e tyre për të konsoliduar më tej përparimin e dukshën, të vlerësuar tashmë edhe nga institucionet e BE-së;

- Vlerëson Rezolutën e datës 26 nëntor 2009 të Parlamentit European, në të cilën shprehet mbështetja që liberalizimi i vizave të mund të realizohet deri në korrik 2010;

- Shpreh njëherazi kënaqësinë për përfundimin e misioneve të ekspertëve të Komisionit European dhe besimin se Komisioni do të realizojë përgatitjen e raportit vlerësues në fillim të pranverës 2010 për t'i hapur rrugën marrjes së vendimit nga Këshilli për liberalizimin e vizave nga Këshilli i BE-së para muajit korrik 2010;

- Mirëpret që Parlamenti European, vendet anëtare dhe Komisioni European të marrin në konsideratë përmbushjen e detyrimeve të Udhërrëfyesit nga Shqipëria, si dhe konsensusin që ekziston mes të gjitha forcave politike të Republikës së Shqipërisë për të arritur udhëtimin pa viza të qytetarëve shqiptarë në hapësirën *Schengen*, si pjesë e aspiratës së tyre për lirinë e lëvizjes.

11 mars 2010

**VENDIM**  
**Nr. 21, datë 4.3.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.166, DATË 16.12.2004 “PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 8 pika 2, fjalët “2 zëvendëskryetarë” zëvendësohen me fjalën “zëvendëskryetarët”.

2. Në nenin 20, pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve shumicë parlamentare-opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.22, datë 4.3.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.3, DATË 16.9.2009 “PËR  
KAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të neneve 20 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktohen deputetët:

1. Mesila Doda	Anëtar	(PD)
2. Aldo Bumçi	“	“
3. Fatos Hoxha	“	“
4. Edi Paloka	“	“
5. Arben Isaraj	“	(PS)
6. Armando Subashi	“	“

7. Bashkim Fino	“	“
8. Damjan Gjikhuri	“	“
9. Dashmir Peza	“	“
10. Ermonela Felaj	“	“
11. Fatmir Xhafaj	“	“
12. Pandeli Majko	“	“
13. Saimir Tahiri	“	“
14. Shegush Ligori	“	“
15. Tom Doshi	“	“
16. Vasilika Hysi	“	“

II. Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat caktohen deputetët:

1. Flamur Noka	Anëtar	(PD)
2. Adriana Gjonaj	“	“
3. Luan Skuqi	“	“
4. Albert Çaçi	“	(PS)
5. Andis Harasani	“	“
6. Arben Ahmetaj	“	“
7. Arben Malaj	“	“
8. Erion Braçe	“	“
9. Ervin Koçi	“	“
10. Gjovalin Kadeli	“	“
11. Ilir Bejtja	“	“
12. Mimi Kodheli	“	“
13. Rudina Seseri.	“	“

III. Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare caktohen deputetët:

1. Gazmend Oketa	Anëtar	(PD)
2. Ardian Turku	“	“
3. Osman Metalla	“	“
4. Arben Çuko	“	(PS)
5. Armando Prenga	“	“
6. Asllan Dogjani	“	“
7. Ben Blushi	“	“
8. Gazmir Bizhga	“	“
9. Pirro Lutaj	“	“
10. Skënder Hasa	“	“
11. Xhemal Qefalia.	“	“

IV. Në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktohen deputetët:

1. Syhbi Hida	Anëtar	(PD)
2. Selami Xhepa	“	“
3. Ismail Hoxha	“	“
4. Kreshnik Çipi	“	“
5. Rrahim Çota	“	“
6. Artan Gaci	“	(PS)
7. Besnik Baraj	“	“
8. Blendi Klosi	“	“
9. Eduart Shalsi	“	“
10. Fatos Tushe	“	“

11. Gjok Jaku	“	“
12. Hazir Gashi	“	“
13. Ilir Beqaj	“	“
14. Namik Dokle	“	“
15. Ndue Kola	“	“
16. Sadri Abazi.	“	“

V. Në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik caktohen deputetët:

1. Gent Strazimiri	Anëtar	(PD)
2. Gerti Bogdani	“	“
3. Fatbardh Kadilli	“	“
4. Agim Leka	“	(PS)
5. Alfred Dalipi	“	“
6. Enkelejda Shkreli	“	“
7. Fatmir Toçi	“	“
8. Fidel Ylli	“	“
9. Kastriot Islami	“	“
10. Luiza Xhuvani	“	“
11. Marko Bello	“	“
12. Valentina Leskaj.	“	“

Deputetja Mesila Doda largohet nga ky komision.

VI. Në Komisionin për Integrimin European caktohen deputetët:

1. Sheferedin Shehu	Anëtar	(PD)
2. Mesila Doda	“	“
3. Ditmir Bushati	“	(PS)
4. Ermelinda Meksi	“	“
5. Gramoz Ruçi	“	“
6. Taulant Balla	“	“

Deputeti Fatbardh Kadilli largohet nga ky komision.

VII. Në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë caktohen deputetët:

1. Besnik Dusha	Anëtar	(PD)
2. Albana Vokshi	“	“
3. Astrit Beci	“	(PS)
4. Eglantina Gjermeni	“	“
5. Eltar Deda	“	“
6. Et'hem Ruka	“	“
7. Klodiana Spahiu	“	“
8. Vangjel Tavo.	“	“

VIII. Në Komisionin për Politikën e Jashtme caktohen deputetët:

1. Florion Mima	Anëtar	(PD)
2. Arta Dade	“	(PS)
3. Ilir Gjoni	“	“
4. Olta Xhaçka	“	“
5. Qemal Minxhozi.	“	“

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**DEKRET**  
**Nr.6436, datë 24.2.2010**

**PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Loreta Filip Stolze (Petani)
2. Kozeta Reiz Vogelius (Mezini)
3. Edmond Qani Kuka
4. Danjela Barjam Terpollari (Xhomaqi)
5. Ledjan Nazif Duzha
6. Ilir Mus Aliaj
7. Shpëtim Sadik Sylshabanaj
8. Klajdi Shpëtim Sylshabanaj
9. Armela Fatmir Hoxha
10. Erilda Sofo Metaj
11. Ferdinand Veri Kamenica
12. Fjona Ferdinand Kamenica
13. Lindita Guran Elmazi (Hoxha)
14. Heidi Dhimitraq Elmazi
15. Hansi Dhimitraq Elmazi
16. Benjola Fatmir Kapllani
17. Emiola Bajram Schnitzler (Hysenbelliu)
18. Marije Vuksan Freudenberg (Hili)
19. Sabaudin Rasim Dervishi
20. Kevin Gëzim Çela
21. Jessica Gëzim Çela
22. Gëzim Fejzi Brahim
23. Adrian Bajram Shkreta
24. Sabrina Adrian Shkreta
25. Arben Deli Lugjaj
26. Gjergj Kol Ndoci
27. Klaus Gjergj Ndoci
28. Gent Gjergj Ndoci
29. Helidon Shaban Keku
30. Anila Helidon Keku
31. Leticia Helidon Keku
32. Ilda Lek Keku (Pergjini)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6442, datë 3.3.2010**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mehmet Seyhan Abdulkadir Pencabligil
2. Isuf (Jusuf) Haxhia Halilaj (Haliloviç)
3. Genc Rrustem Krasniqi
4. Violeta Tun Llaçi (Hila)
5. Demë Hasan Elezaj
6. Cemil Nazmi Meriç
7. Fesel Al Fahim Ebu Al Kasim Saker
8. Jusuf Ibrahim Abdul
9. Taulant Jusuf Abdul
10. Alketa Jusuf Abdul
11. Erol Veli Söğütlü
12. Abdurrahim Mustafa Zeybek

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6443, datë 3.3.2010**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7, nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:  
Flamur Muhamet Vezaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE .....	240 lekë
KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL .....	410 lekë
KODI I PUNËS .....	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK .....	55 lekë
KODI I FAMILJES .....	270 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE .....	90 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 12.3.2010

Doli nga shtypi më 12.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 12 lekë